

Qendra e Rinisë Rurale Rural Youth Hub

Strategjia e

Aadvokacisë

dhe

Plani i

Veprimit

Nëntor 2023

Përmbajtja

1. Hyrje	3
1.1 Përshkrimi i procesit	3
2. Analiza e situatës së të rinjve në zonat rurale	4
2.1 Kuadri ligjor dhe institucional për mbështetjen e të rinjve	4
2.2 Mbështetja financiare për të rinjtë nga zonat rurale.....	5
2.3 Përfshirja e të rinjve në bujqësi dhe migrimi	6
2.4 Situata e infrastrukturës dhe edukimit	7
2.5 Punësimi, mundësitë ekonomike dhe cilësia e jetës.....	7
2.6 Angazhimi politik dhe civil i të rinjve nga zonat rurale.....	8
3. Objektivat dhe e qëllimet e advokacisë rinore rurale	8
4. Plani i veprimit	10

1. Hyrje

Aktivizmi rinor dhe advokacia nga poshtë-lart është thelbi i veprimtarisë së Qendrës së Rinisë Rurale (RYH). RYH mbështet të rinjtë në zonat rurale që të ushtrojnë zërin e tyre për të ndikuar politikëbërjen bujqësore dhe rurale, për t'i bërë këto procese të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.

Misioni: RYH – platformë e aktivizimit rinor që krijon hapësirë të qëndrueshme dhe fuqizuese që mbështet zhvillimin personal dhe profesional të të rinjve të komuniteteve rurale. Për të arritur këtë mision, RYH syton të bëhet një Platformë e qëndrueshme e njohur në nivelin kombëtar si përfaqësuese e nevojave dhe modeleve të të rinjve nga Shqipëria rurale.

Për të arritur misionin tonë, veprimet kryesore të kësaj Strategjie do të fokusohen në rritjen e bazës së anëtarësisë, dhe përfaqësimit të rinisë rurale në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Anëtarësia e rritur dhe përfaqësuese e rinisë në zonat rurale të vendit, strukturimi i procesit të anëtarësimit dhe mirëmbajtja e rifreskimi i të dhënave të anëtarëve do të krijojë terrenin e duhur për legjitimitet të RYH dhe veprimtarisë së tij në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe avancimit të interesave dhe prioritetëve të të rinjve rural. Gjithashtu, aktivitetet synojnë ta kthejnë RYH në një platformë të qëndrueshme të advokacisë për çështjet e të rinjve në komunitet rurale.

Për të patur një vizion të qartë të çështjeve kryesore në të cilat do të bazohet advokacia rinore, RYH ka përgatitur Strategjinë e Advokimit dhe Planin e Veprimit. Anëtarët e Qendrës së Rinisë Rurale u përfshinë në procesin e identifikimit të sfidave dhe prioritetëve kryesore të të rinjve në zonat rurale.

Pas analizës së detajuar të çështjeve kryesore dhe sfidave me të cilat përballen të rinjtë në zonat rurale u identifikuan 3 fusha prioritare:

1. **Konsolidimi i Qendrës së Rinisë Rurale** drejt një platforme funksionale përmes anëtarësisë së zgjeruar dhe përfaqësuese e të rinjve në komunitet rurale të Shqipërisë.
2. Rritja e **infuencës së Qendrës së Rinisë Rurale në politikëbërje dhe vendimarrjen qendrore dhe vendore** duke avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve në zonat rurale.
3. **Animimi i përprjekjeve advokuese rinore nga poshtë lart dhe me pjesëmarrje** për një sektor bujqësor dhe rural dhe komunitete rural që ofrojnë mundësi dhe perspektivë të sigurt për të ardhmen.

Gjithashtu dokumenti përshkruan aktivitetet që do të organizohen në të ardhmen nga Qendra e Rinisë Rurale.

1.1 Përshkrimi i procesit

Strategjia e Advokacisë dhe Plani i Veprimit u përgatit bazuar në inute dhe kontribute nga të rinjtë e komuniteteve të ndryshme rurale të ofruara në aktivitete me natyrë të lartë pjesëmarrëse të organizuara nga RYH në kuadër të porjektit Rinia rurale shqiptare. Kryesisht, një rol të rëndësishëm kanë luajtur workshopet dhe trajnimet me të rinjtë që u organizuan gjatë Asamblesë së Parë kombëtare të të Rinjve në Zonat Rurale,- e organizuar në kuadër të Parlamentit të tretë rural shqiptar, 11-13 tetor. Gjithashtu, u pëdorën të dhëna dytësore nga raporte të ndryshme në lidhje me të rinjtë në zonat rurale.

Asambleja e Parë e të Rinjve në Zonat Rurale me moton “*me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë*” bëri bashkë mbi 100 pjesëmarrës të rinj nga komunitete të ndryshme. Diskutimi u zhvillua duke përdorur metodën World Café që është një format i thjeshtë, efektiv dhe fleksibël për organizimin e diskutimit në grupe të mëdha. Gjatë zhvillimit të Asamblesë të rinjtë u ndanë në tre grupe me pothuajse 30 anëtarë. Secili grup punoi me një nga tre tematikat e përzgjedhura, të cilat u fokusuan në: 1) identifikimi i sfidave me të cilat përballen të rinjtë në zonat rurale, 2) skenarët e mundshëm të ecures së zonave rurale në vitet e ardhshme dhe, 3) paraqitja me vizatim i imazhit të fshatit të tyre të ëndrrave.

Procesi vijoi me analizimin e inputeve të mbledhura nga diskutimet me të rinjtë pjesëmarrës dhe rishikimin e literaturës për burime dytësore nga anëtarët e Qendrës së Rinisë Rurale. Inputet e grumbulluara u përdorën për të hartuar draftin e Strategjisë, e cila më pas u shqyrtua nga anëtarët e Bordit të RYH.

2. Analiza e situatës së të rinjve në zonat rurale

2.1 Kuadri ligjor dhe institucional për mbështetjen e të rinjve

Kuadri institucional dhe ligjor për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri përfshin dokumente ligjore dhe strategjike, plane veprimi dhe programe që synojnë krijimin e një mjedisi të favorshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve. Ligji për të rinjtë në Shqipëri e përcakton “*Politikën për të rinjtë*” si një aktivitet gjithëpërfshirës të qëndrueshëm të ndërmarra nga pushteti qendror dhe vendor, që synon krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike, kulturore lokale dhe në nivel kombëtar, nëpërmjet aktiviteteve që nxisin zhvillimin e rinisë në vend.

Kushtetuta e Shqipërisë njeh dhe mbron të drejtat e të rinjve. Ajo parashikon mbrojtje të veçantë për të rinjtë: “*Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti*”. Kushtetuta nuk bën referenca specifike për rininë dhe as nuk jep një përkufizim të rinisë.

Ligji 75/2019 “Për Rininë” përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të të rinjve në Shqipëri. Ligji për Rininë është kuadri kryesor ligjor që synon të promovojë pjesëmarrjen, angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Ligji synon mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, krijimin e një mjedisi të nevojshëm për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë aktivitete për të rinjtë.

Strategjia Kombëtare për Rininë për periudhën 2022-2029 pasqyron angazhimin e Shqipërisë për të investuar tek të rinjtë e saj dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha aspektet e shoqërisë. Vizioni është t'u japim mundësi dhe të mbështesim të rinjtë që të bëhen partnerë aktivë në zhvillimin e Shqipërisë. Strategjia propozon tre politika në fushën e rinisë, përkatësisht koordinimin e politikave ndërsektoriale rinore; inovacioni, aftësitë dhe

profesionalizmi dhe tregu i punës dhe mirëqenia e përgjithshme e të rinjve. Kostot e parashikuara në këtë strategji arrijnë në 7.7 miliardë lekë, ndërsa fondi për vitin 2022 për mbështetjen e të rinjve është 161.3 milionë lekë ose 0.05 për qind e buxhetit 2022.

Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (SARDF) 2021-2027 është dokumenti kryesor politik që përcakton kuadrin strategjik për të mbështetur zhvillimin e sektorëve të bujqësisë dhe peshkimit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural. Strategjia ofron një kuadër gjithëpërfshirës për mbështetjen e të rinjve në zonat rurale duke promovuar mundësi punësimi për të rinjtë dhe sipërmarrjen, duke përmirësuar aksesin në arsim dhe trajnim, duke mbështetur infrastrukturën rurale, duke promovuar dhe ndihmuar për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të zonave rurale.

2.2 Mbështetja financiare për të rinjtë nga zonat rurale

Ofrimi i mbështetjes financiare është element kyç për të inkurajuar të rinjtë në zonat rurale të angazhohen në bujqësi, zhvillim rural dhe sipërmarrje. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmbledhura disa nga masat mbështetëse për të rinjtë e zonave rurale, kryesisht të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural

Tabela 1. Masat mbështetëse për të rinjtë në zonat rurale

Masa	Përshkrimi
Mbështetja e të ardhurave nga ferma për sipërfaqe bujqësore të shfrytëzuar	Masa përfshin si përfitues fermerët e rinj – shfrytëzues të tokës bujqësore. Ajo do të sigurojë mbështetje të të ardhurave për fermerët e rinj (start-up) për një kohëzgjatje maksimale prej pesë vjetësh, duke filluar nga viti i parë i paraqitjes së aplikimit për pagesën për fermerët e rinj.
Grante për fermerët e rinj	Synon fermerët të rinj dhe femrat (deri në 40 vjeç) dhe drejtuesit e rinj të fermave. Mbështetja financiare do të sigurohet për fillimin e sipërmarrjeve në zonat rurale (start-up), përfshirë krijimin e fermave të reja.
Grante për bizneset në zonat rurale dhe start-up	Synon bizneset e regjistruara në zonat rurale. Investimet në asete fizike dhe marketingun e bizneseve ekzistuese në zonat rurale ose start-up (vetëm për të rinjtë deri në 40 vjeç dhe sipërmarrëset femra) në sektorët prioritarë.
Grantet për turizmin rural	Synon infrastrukturën turistike në vend, si rinovimi i bujtinave dhe shtëpive në stilin arkitektonik tradicional për qëllime akomodimi, mobilimi, pajisjet sportive, rekreative dhe agroturizmin, rrugët e brendshme dhe vendet e parkimit, objektet e ujërave të zeza dhe mbetjeve.
Mbështetje për start-up për të rinjtë e diplomuar në sektorin e bujqësisë	Mbulon një program të posaçëm start-up për të diplomuar në degë të lidhura me zhvillimin e biznesit në zonat rurale të lidhura me sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit.
Programi i Zhvillimit Rural 2021-2027 nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPARD III)	Programi IPARD III ka prioritet mbështetjen për të rinjtë dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre në program. Ai ju dedikon një pjesë të konsiderueshme të buxhetit total veçanërisht për fermerët e rinj dhe sipërmarrësit nën moshën 40 vjeç. Për këtë qëllim, kriteret e përzgjedhjes u japin më shumë pikë kandidatëve të rinj/gra.
Programi i Praktikës së Punës	Ofron praktika për të diplomuarit në universitet për të fituar përvojë pune në administratën publike. Programi filloi në vitin 2007 dhe është i hapur për profesionistët e rinj të moshës 21 deri në 26 vjeç, të cilët kanë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve bachelor. Periudha e praktikës është e papaguar dhe synon përfshirjen e pjesëmarrësve në fitimin e një eksperience kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale.

<p>Planet Lokale të Veprimit për Rininë</p>	<p>Janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave vendore në fushën e rinisë. Shumë bashki në Shqipëri kanë zhvilluar Plane Lokale Veprimi për Rininë në nivel bashkie me mbështetjen e qeverisë dhe aktorëve të tjerë. Këto plane synojnë të adresojnë nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen të rinjtë në secilën komunë dhe të ofrojnë një udhërrëfyes për zhvillimin e të rinjve për një periudhë të caktuar kohore.</p>
---	---


2.3 Përfshirja e të rinjve në bujqësi dhe migrimi

Të rinjtë nga zonat rurale e vënë theksin tek pamjaftueshmëria e të ardhurave që gjenerohen nga blegtoaria, bujqësia dhe bletaria, dhe shpesh ata luftojnë për të siguruar jetesë të përshtatshme. Përfshirja e kufizuar e vajzave në bujqësi në zonat rurale për shkak të roleve tradicionale gjinore i dekurajon vajzat të angazhohen në aktivitete bujqësore. Ekziston një perceptim se bujqësia është më e përshtatshme për burrat dhe vajzat pritet të martohen dhe të jetojnë në shtëpinë e burrit të tyre: të afërmit dhe anëtarët e fisit shpesh nuk e pranojnë se një dhëndër mund të punojë në shtëpinë e tyre.

Natyra intensive e punës në bujqësi dhe të ardhurat e ulëta që gjenerohen në këtë sektor kontribuojnë në dëshirën e të rinjve për t'u larguar nga zonat rurale. Shqipëria renditet ndër vendet me numrin më të lartë të të rinjve të lagruar nga vendi. Sipas studimeve rreth 35% e të rinjve të diplomuar në bachelor dëshirojnë që studimet e tyre të mëtejshme t'i kryejnë jashtë vendit. Sipas studimeve, 79% e të rinjve duan që të largohen nga vendi, duke e renditur Shqipërinë në krye të listës së vendeve me trendin më të lartë të largimit të të rinjve. Ka patur një rritje të personave që kanë zgjedhur të migrojnë.

Faktorët që influencojnë largimin e të rinjve nga zonat rurale janë të shumtë. Disa prej tyre janë të identifikuar në diagramën e mëposhtme.

Figura 1 Diagrama e problemeve



Burimi: RTM-Voluntari Nel Mondo, (2022)

Figura është përgatitur nga pjesëmarrës të rinj në Asamblenë lokale të organizuar në kuadër të zbatimit të projektit Rural Albanian Youth! Rural You, në zonat rurale të Shqipërisë së Veriut. Gjithashtu nga diskutimet e kryera me të rinjtë gjatë ëorkshopeve të Asamblesë së Parë të të Rinjve nga Zonat Rurale, një pjesë e madhe e tyre duan të lëvizin jashtë vendit në kërkim

të mundësive të punësimit, një jete më sociale, por çka është dhe më e rëndësishmja në kërkim të shpresës.

2.4 Situata e infrastrukturës dhe edukimit

Zonat rurale karakterizohen nga një mungesë e aksesit në shërbimet publike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Disa nga mungesat kryesore të identifikuar nga vetë të rinjtë e zonave rurale janë: ndriçimi i rrugëve, shërbimi i zjarrfikësve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike, hapësirat/aktivitetet sportive, aktivitetet kulturore dhe strehimi social. Për më tepër, banorët në zonat rurale i perceptojnë shërbimet që marrin si të një cilësie më të ulët në krahasim me ato në zonat urbane. Dallimet më domethënëse vërehen në sistemin e kanalizimeve, mirëmbajtjen e rrugëve, pastrimin dhe ndriçimin publik si dhe transportin publik. Kjo gjë është nxjerrë në pah nga studime të cilat e vënë theksin tek papërshtatshmërinë e infrastrukturës publike sociale dhe ekonomike lokale në zonat rurale. Aspekte si mungesa e aksesit në shërbime bazë si uji i pijshëm, sistemet e menaxhimit të mbeturinave dhe energjia elektrike është një çështje e përmendur zakonisht. Të rinjtë në zonat rurale përballen me mungesën e shërbimeve shëndetësore. Situata është përkeqësuar edhe më shumë gjatë viteve të fundit për shkak të emigrimi i stafit shëndetësor, mungesa e tyre ndjehet edhe më shumë në zonat e thella malore, ku pacientët duhet të kalojnë peripeci të shumta për të siguruar shërbim shëndetësor.

Edukimi është një nga faktorët kryesorë që nxit largimin e të rinjve nga zonat rurale. Studimet kanë treguar performancë më të ulët akademike midis të rinjve ruralë në krahasim me të rinjtë në zonat urbane. Mundësitë e kufizuara arsimore prekin kryesisht të rinjtë ruralë të cilët përballen me sfida në aksesin e arsimit të mëtejshëm përtej shkollimit të detyrueshëm. Të rinjtë pjesëmarrës theksuan sfidat me të cilat përballen aksesin në arsim cilësor dhe se si kjo ndikon në të ardhmen e tyre. Cilësia e ulët e mësimdhënies është një tjetër aspekt shumë shqetësues kur bëhet fjale për edukimin në zonat rurale. Për shkak të mungesës së nxënësve mësuesit shpesh janë të detyruar të japin lëndë jashtë profilit të tyre për të mbuluar orët e mësimi. Gjithashtu arsimi profesional është i nënvlerësuar në zonat rurale, pasi shpesh shihej si një alternativë për nxënësit me performancë të ulët në shkollë. Prindërit shpesh zgjedhin që t'i drejtojnë fëmijët drejt zonave urbane për shkak të mundësive të kufizuara arsimore. Nga ana tjetër mungesa e aksesit apo arsimimi cilësor ndikon në dëshirën e studentëve për t'u larguar nga zona.

2.5 Punësimi, mundësitë ekonomike dhe cilësia e jetës

Të rinjtë në zonat rurale përballen me një sërë kufizimesh përsa i përket mundësive të punësimit. Sipas studimeve të kryera për të rinjtë në zonat rurale sektori publik shihet si i ndikuar politikisht, duke e bërë të vështirë sigurimin e punësimit pa lidhje politike, ndërsa sektori privat ofron perspektiva të kufizuara pune në zonat rurale. Për të rinjtë në zonat rurale është e vështirë të gjejnë punë që përputhen me aftësitë e tyre. Në diskutimet e zhvilluara të rinjtë shprehen se zonat rurale nuk ofrojnë perspektiva të rëndësishme punësimi, duke i bërë të rinjtë e diplomuar të mos kthehen në vendlindjet e tyre. Mundësia kryesore e punësimit për të rinjtë në këto zona është bujqësia dhe turizmi. Zhvillimit i sipërmarrjeve bujqësore është i lidhur ngushtë me pronësinë e tokës ose trashëgiminë e bizneseve familjare. Aksesin e kufizuar

në tokë, procedurat burokratike dhe mungesa e mbështetjes financiare penguan aftësinë e të rinjve për t'u përfshirë në sipërmarrje. Të rinjtë theksuan gjithashtu rëndësinë e politikave mbështetëse të qeverisë, duke përfshirë uljen e taksave, rritjen e subvencioneve, aksesin më të lehtë në kredi, për të inkurajuar sipërmarrjen dhe krijimin e vendeve të punës në zonat rurale.

Mungesa e jetës sociale dhe e mundësive për shfrytëzimin e kohës së lirë janë të fenomene të pranishme në zonat rurale. Të rinjve në zonat rurale ju duhet të punojnë më shumë orë në ditë, të angazhohen në më pak aktivitete shoqërore me miqtë dhe udhëtojnë më pak në krahasim me të rinjtë e të rinjve në zonat urbane. Një problem tjetër për të rinjtë e zonave rurale është mungesa e angazhimit social në praktika, aktivitete vullnetare etj.

Në pamundësi të jetës sociale teknologjia dhe interneti janë burimet e vetme të ndërveprimit social. Meshkujt në zonat rurale kanë më shumë mundësi, sic është mbledhja në kafene, ndërsa paragjykimi nga komuniteti i kufizon vajzat të vizitojnë kafenetë dhe aktivitetet e organizuara nga institucionet fetare janë vetëm për burrat. Jeta e kufizuar sociale nuk konsiderohet si arsyeja kryesore e emigrimit të të rinjve nga zonat rurale, por si një faktor kontribues për moskthimin e tyre në këto zona pas largimit. Mjedisi i mbyllur dhe konservator pengon zhvillimin e të rinjve. Popullsia në zonat rurale, bazohet akoma në rregullat tradicionale që përcaktojnë mënyrën e sjelljes së të rinjve dhe dikton zgjedhjet e tyre.

2.6 Angazhimi politik dhe civil i të rinjve nga zonat rurale.

Angazhimi civil dhe pjesëmarrja politike mbeten në nivele shumë të ulëta në Shqipëri. Kjo situatë lidhet me ndikimin e kufizuar që ata besojnë se mund të kenë në ndryshimin e gjendjes së zonave rurale. Shumica e të rinjve në Shqipëri nuk janë të interesuar për proceset politike. Ky mosinteresim për politikën është konsistent si tek të rinjtë urbanë ashtu edhe ato rurale, duke sugjeruar një indiferencë të gjerë tek popullsia e re në nivel vendi. Të rinjtë shprehen se angazhimi politik nxitet nga përfitimi personal ose përkatësia me një parti të caktuar. Mendësia patriarkale është theksuar si një pengesë e rëndësishme për pjesëmarrjen politike dhe vendimmarrjen e vajzave. Normat gjinore dhe mungesa e mundësive të transportit përmenden si sfida specifike me të cilat përballen vajzat në zonat rurale. Të gjitha grupet konfirmojnë Ekziston një mungesë e përgjithshme e proaktivitetit dhe ndjenjës së demotivimit tek të rinjtë kur bëhet fjalë për angazhimin qytetar dhe politik.

Ligji për të rinjtë parashikon krijimin e Këshillit Rinor Vendor në 61 bashki shqiptare. Nga anketa për monitorimin e zbatimit të ligjit në tetor 2021 rezulton se 46% e bashkive nuk kanë themeluar Këshillin Rinor Vendor, ndërsa 54% e tyre ishin në proces të themelimit. Bashkitë duhet të hartojnë Plane Vendore të Veprimit për Rininë në nivel bashkiak me mbështetjen e qeverisë dhe palëve të tjera të interesuara. Këto plane synojnë të adresojnë nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen të rinjtë në secilën bashki dhe të ofrojnë një udhërrëfyes për zhvillimin e të rinjve për një periudhë të caktuar kohore. Megjithatë shumica e bashkive nuk i kanë zhvilluar këto plane.

3. Objektivat dhe e qëllimet e advokacisë rinore rurale

Objektivat e advokacisë së Qendrës së Rinisë Rurale janë:

1. Konsolidimi i Qendrës së Rinisë Rurale drejt një platforme funksionale përmes anëtarësisë së zgjeruar dhe përfaqësuese e të rinjve në komunitet rurale të Shqipërisë.
2. Rritja e influencës së Qendrës së Rinisë Rurale në politikëbërje dhe vendimarrjen qendrore dhe vendore duke avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve në zonat rurale.
3. Animimi i përpjekjeve advokuese rinore nga poshtë lart dhe me pjesëmarrje për një sektor bujqësor dhe rural dhe komunitete rurale që ofrojnë mundësi dhe perspektivë të sigurt për të ardhmen.

Qendra e Rinisë Rurale do të synojë të sigurojë mbështetje që do të mundësojnë përmes hartimit të projekteve specifike ose përmes përfshirjes së aktiviteteve në projekte të tjera.

Lista e mëposhtme paraqet rezultatet e pritshme nga secili prej objektivave.

I. Qendra e Rinisë Rurale është një platformë funksionale përmes anëtarësisë së zgjeruar dhe përfaqësuese e të rinjve në komunitet rurale të Shqipërisë

- 1.1 Anëtarësi e zgjeruar e Qendrës së Rinisë Rurale gjeografikisht dhe tematikisht;
- 1.2 Dinamikë e rritur e brendshme dhe vizilitet i përmirësuar i RYH në nivele të ndryshme;
- 1.3 Qeverisje e brendshme e RYH transparente dhe e përgjegjshme.

2. Rritja e influencës së Qendrës së Rinisë Rurale në politikëbërje dhe vendimarrjen qendrore dhe vendore duke avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve në zonat rurale

- 2.1 Kapacitete institucionale të RYH përmirësuar;
- 2.2 Bashkëpunim i rritur me institucionet publike dhe përfshirja e RYH në proceset e qeverisjes
- 2.3 Rrjetëzim i rritur i RYH me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Animimi i përpjekjeve advokuese rinore nga poshtë lart dhe me pjesëmarrje për një sektor bujqësor dhe rural dhe komunitete rurale që ofrojnë mundësi dhe perspektivë të sigurt për të ardhmen

- 3.1 Konsultime të rregullta, me orientim nga poshtë lart me anëtarësinë për çështjet të rëndësishme të të rinjve nga zonat rurale;
- 3.2 Nisma të ndryshme janë inicuar dhe zbatuar nga RYH për të avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve rural;
- 3.3 Asambleja e të rinjve nga zonat rurale organizohet në mënyrë të rregull nga RYH.

4. Plani i veprimit

Objektivi specifik 1: Konsolidimi i Qendrës së Rinisë Rurale drejt një platforme funksionale përmes anëtarësisë së zgjeruar dhe përfaqësuese e të rinjve në komunitet rurale të Shqipërisë

Rezultatet	Aktivitetet	Indikatorët
1.1 Anëtarësi e zgjeruar e Qendrës së Rinisë Rurale gjeografikisht dhe tematikisht;	<p>1.1.1 Krijimi i paketës informuese rreth “Qendrës së Rinisë Rurale”; kartës së anëtarësisë; pyetësorit për databazën;</p> <p>1.1.2 Nxitja e anëtarësimit në RYH përmes: komunikimit me anëtarët e RYH; organizatave anëtare të ANRD, dhe medias sociale;</p> <p>1.1.3 Fushatë informuese në institucione të arsimit të lartë, si Universiteti Bujqësor i Tiranës;</p> <p>1.1.4 Krijimi i databazës së anëtarëve, mirëmbajtjes së saj dhe përditësimit në baza të rregullta kohore;</p> <p>1.1.5 Pajisja e anëtarëve me kartat e anëtarësisë dhe rinovimi i tyre;</p> <p>1.1.6 Gjenerimi i të dhënave të anëtarësisë dhe ndarja me publikun;</p> <p>1.1.7 Kryerja e fushatave të anëtarësisë në mënyrë të rregullt, kombëtare apo rajonale, përmes Ditëve të Anëtarësisë.</p>	Rritja e anëtarëve në +500 anëtarë
1.2 Dinamikë e rritur e brendshme dhe vizilitet i përmirësuar i RYH në nivele të ndryshme;	<p>1.2.1 Shqyrtimi nga bordi dhe aprovimi nga Asambleja e Rregullores së funksionimit të anëtarësisë në bazë të forumeve rajonale; Forumet e Drinit, Arbërit, Vjosës dhe Egnatia.</p> <p>1.2.2 Organizimi i anëtarësisë bazuar në forume rajonale përmes takimeve të anëtarësisë aktive në një rajon të caktuar në përputhje me Rregulloren;</p> <p>1.2.3 Përzgjedhja e Koordinatorëve Rajonale nga anëtarësia përkatëse e cdo forumi;</p> <p>1.2.4 Organizimi i takimeve të rregullta të forumeve rajonale;</p> <p>1.2.5 Përgatitja, mirëmbajtja dhe përditësimi i anëtarësisë së forumeve rajonale;</p> <p>1.2.5 Organizimi i takimeve ndërmjet koordinatorëve rajonalë;</p> <p>1.2.6 Prezencë e rritur në median kombëtare dhe lokale dhe rrjetet sociale të përfaqësuesve të RYH.</p>	
1.3 Qeverisje e brendshme e RYH transparente dhe e përgjegjshme	<p>1.3.1 Takime të rregullta periodike të Bordit dhe dokumentimi i tyre;</p> <p>1.3.2 Takime të rregullta të Asamblesë (të paktën 1 herë në vit) dhe dokumentimi i tyre;</p>	

	<p>1.3.3 Zbatimi i vendimarrjeve, moniotimi dhe raportimi i tyre;</p> <p>1.3.4 Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit dhe Koordinatorëve rajonalë në trajnime të ndryshme për menaxhimin e OJF dhe qeverisjen e tyre;</p> <p>1.3.5 Publikimi i rezultateve të punës me publikun përmes website dhe medias sociale.</p>	
<p>Objektivi specifik 2: Rritja e influencës së Qendrës së Rinisë Rurale në politikëbërje dhe vendimarrjen qendrore dhe vendore duke avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve në zonat rurale.</p>		
<p>2.1 Kapacitete institucionale të RYH përmirësuar;</p>	<p>2.1.1 Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të organizatës përmes trajnimeve në lidhje me leadershipin, advokacinë, ciklin e menaxhimit të projekteve, etj.</p> <p>2.1.2 Paisja e të rinjve në zonat rurale me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për hulumtimin e politikave të publike për zhvillimin rural dhe advokacinë për politika të udhëhequra nga të rinjtë;</p> <p>2.1.3 Trajnimi i një grupi të vogël nga RYH si ToT për qasjen Leader, sipërmarrjen dhe ndryshimet klimatike si dhe tema të tjera relevante për rininë e zonave rurale;</p>	
<p>2.2 Bashkëpunim i rritur me institucionet publike dhe përfshirja e RYH në proceset e qeverisjes</p>	<p>2.1 Nënshkrimi i MoU me Universitetin Bujqësor të Tiranës: zhvillimin e praktikave profesionale; angazhimin e të rinjve nga zonat rurale në projekte të kërkimit shkencor; përgatitja e tezave të studimit në çështje që janë në fokus të advokacisë së RYH.</p> <p>2.2 Rritja e komunikimit institucional me AKR dhe përfshirja e të rinjve në konsultime të programeve të ndryshme rinore dhe përhapjen e informacionit në lidhje me to;</p> <p>2.3 Rritja e komunikimit institucional me MBRZR dhe të tjera ministre të linjës, si psh M.Edukimit, M.Rinisë etj.</p> <p>2.4 Vendosja e kontakteve të bashkëpunimit me bashkitë e vendit dhe institucione të tjera publike;</p> <p>2.5 Prezencë dhe pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të RYH në aktivite të ndryshme të zhvilluar si në nivel kombëtar ashtu edhe lokal.</p>	
<p>2.3 Rrjetëzim i rritur i RYH me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>	<p>2.3.1 Pjesëmarrje dhe kontribut në aktivitetet, nismat dhe takimet e organizuara nga ANRD, përfshi Mbledhjen vjetore të Asamblesë;</p> <p>2.3.2 Zbatimi dhe monitorimi i Marrëveshjes më AGIA-CIA</p> <p>2.3.3 Pjesëmarrje dhe kontribut në aktivitetet, nismat dhe takimet e Rural Youth Europe;</p>	

	<p>2.3.3 Pjesëmarrje e anëtarëve në takime dhe aktivitete të ndryshme rrjetëzuese si në nivel kombëtar ashtu dhe rajonal dhe evropian (Parlamenti Rural Ballkanik, Parlamenti Rural Evropian, Kampi rajonal i të rinjve nga zonat rurale, aktivitete të RYE etj);</p> <p>2.3.4 Shprehja e interesit dhe përfshirja në nismat relevante advouese të organizatave dhe rrjeteve të organizatave të tjera si brenda vendit, ashtu dhe jashtë Shqipërisë.</p>	
--	--	--

Objektivi specifik 3: Animimi i përpjekjeve advokuese rinore nga poshtë lart dhe me pjesëmarrjepër një sektor bujqësor dhe rural dhe komunitete rural që ofrojnë mundësi dhe perspektivë të sigurt për të ardhmen.

<p>3.1 Konsultime të rregullta, me orientim nga poshtë lart me anëtarësinë për çështjet të rëndësishme të të rinjve nga zonat rurale;</p>	<p>3.1.1 Realizimi i konsultimeve pjesëmarrëse me anëtarësinë në baza të rregullta kohore për të identifikuar çështje kritike dhe rekomandime;</p> <p>3.1.2 Përfshirja e aktorëve të ndryshëm të interesit në konsultime për të siguruar një perspektivë të gjerë dhe ndërsektoriale të çështjeve;</p> <p>3.1.2 Përgatitja e dokumenteve të ndryshëm për të informuar strukturat publike dhe aktorë të ndryshëm dhe influencuar veprimet e tyre mbi çështjet e identifikuara;</p>	
<p>3.2 Nisma të ndryshme janë inicuar dhe zbatuar nga RYH për të avancuar interesat dhe prioritetet e të rinjve rural;</p>	<p>3.2.1 Ndërmarrja e veprimeve konkrete nga RYH në lidhje me çështje të rëndësishme të zhvillimit bujqësor dhe rural që prekin të rinjtë dhe komunitet e tyre rurale: qoftë nismë ligjore, advokuese, apo iniciativë zhvillimore në lidhje me (por jo vetëm në):</p> <ul style="list-style-type: none"> a) politika dhe programe pro-të rinjve të zonave rurale; b) përfshirja e të rinjve në vendimarrjen qendrore dhe lokale; c) barazinë gjinore në zhvillimin rural dhe bujqësor dhe në komunitete; d) zhvillimin e integruar vendor sipas Qasjes Leader e) të rinjtë dhe ndryshimet klimatike; f) të rinjtë dhe inovacioni në zhvillimin rural; <p>etj.</p> <p>3.2.2 RYH-mekanizëm efektiv konsultues të politikave kombëtare dhe vendore, përmes proaktivitetit në dhënien e mendimeve, opinioneve dhe sugjerimeve për përmirësimin e politikave të propozuara. Ky proces duhet të bazohet në konsultime intensive me anëtarësinë dhe ndarja e konkluzioneve me institucionet përkatëse;</p> <p>3.2.3 Asambleja e të rinjve nga zonat rurale organizohet në mënyrë të rregull nga RYH – Asambleja përveç forcon qeverisjen e brendshme të RYH, do të perceptohet si një momentum për advokaci të qëndrueshme për çështjet rinore. Inkurajohet përgatitja</p>	

	<p>e deklaratave, peticioneve, thirrjeve të ndryshme për çështje kritike dhe aktuale për komunitet rurale dhe në veçanti të rinjtë rural.</p>	
--	---	--